



FSHV
FEDERATA SHQIPTARE
E VOLEJBOLLIT



KODI I ETIKES DHE RREGULLORJA E DISIPLINES

FAIR PLAY
VOLLEYBALL WAY

TABELA E PERMBAJTJES

Kodi Etikës së FSHV	3
Rregulli 1: Kodi i Etikës.....	4
Rregulli 2: Sjellja	5
Rregulli 3: Konflikti i Interesit.....	8
RREGULLORE E DISIPLINËS E FSHV.....	10
KAPITULLI 1	10
SHTRIRJA E KODIT TË DISIPLINËS.....	10
<i>Aplikimi</i>	10
KAPITULLI 2	11
SANKSIONET.....	12
KAPITULLI 3	14
ORGANET KOMPETENTE PËR DHËNIEN E SANKSIONEVE	14

Kodi Etikës së FSHV

Anëtarët e FSHV-së duhet të punojnë që ndërmjet autoriteteve shtetërore, publike e organizative të aktiviteteve të ndërtohet një marrëdhënie harmonike e qëndrueshme, në përputhje me parimin e gjithanshmërisë e neutralitetit politik për të gjitha aktivitetet e volejbollit. Megjithë shpirtin e humanizmit, vëllazërisë dhe respektin për individin, që frymëzohen nga idealet sportive, të gjithë atyre që do tu delegohet organizimi i aktiviteteve të volejbollit, duhet të kenë parasysh zbatimin me rigorozitet të Statutit, Rregullores së Brendshme e Teknike të FSHV-së e Kodit të Etikës.

Anëtarët e FSHV janë të lirë të luajnë një rol në jetën publike, pavarësisht se kujt spektri politik i përkasin. Ata nuk duhet të angazhohen në veprimtari të cilat bien në kundërshtim me parimet e rregullat e përcaktuara në statutin e FSHV, në Kodin e Etikës.

Anëtarët e FSHV duhet të mbrojnë dhe të kujdesen për mjedisin e infrastrukturën ku zhvillohen aktivitetet e volejbollit.

Ata në çdo rastë duhet të përmbahen standarteve e procedurave të miratuara nga FIVB, CEV e FSHV.

Kodi i Etikës është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjithë anëtarët e FSHV-së. Anëtar të FSHV-së për llogari të këtij kodi janë si më poshtë vijon:

1. Ekipet e Klubeve Sportive dhe Shoqatave Sportive,
2. Komiteti Ekzekutiv dhe komisionet drejtuese të FSHV-së,
3. Sekretariati i FSHV-së,
4. Drejtuesit dhe zyrtarët e Klubeve e Shoqatave Sportive, Sponsorët,
5. Manaxherët e ekipeve, gjyqtarët dhe delegatët Teknik,
6. Lojtarët, trajnerët, mjekët, fizioterapistët, masazhatorët.
7. Lojtarët e ekipeve kombëtare dhe trajnerët e tyre.

Rregulli 1: Kodi i Etikës

- 1.1** Anëtarët e FSHV-së janë subjekt i Statutit të FSHV-së, Rregullorës së Brendshme, vendimeve të marra nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së dhe duhet të zbatojnë ato në mënyrë rigoroze.
- 1.2** Mos zbatimi i rregullave të Kodit të Etikës dënohet nga kjo rregullore e cila aplikohet pa dallim, për të gjithë anëtarët, në çdo disiplinë të volejbollit.
- 1.3** Neglizhimi, mohimi apo injorimi i Kodit të Etikës, nga anëtarët e FSHV nuk do të merret në konsideratë.
- 1.4** Të gjitha Klubet e Shoqatat Sportive, tranjerët, lojtarët, manaxherët, mjekët, fizioterapistët, masazhatorët, drejtuesit e klubeve, sponsorët, zyrtarët e gjyqtarët duhet të zbatojnë në mënyrë rigoroze të gjitha rregullat, në veprimtaritë ku ata marrin pjesë.

Rregulli 2: Sjellja

- 2.1 Anëtarët e FSHV duhet të kenë sjellje në përputhje me principet e dinjitetit, integritetit, besnikësisë dhe përgjegjësi, në raport me aktivitetin sportiv, ekonomik, social dhe moral.
- 2.2 **Dinjitet:** do të thotë respekti për veten, për të drejtën e individit dhe të drejtën e privatësisë. Çdo anëtar i FSHV duhet:
- a. Të mbrojë dinjitetin e çdo individ.
 - b. Të mos diskriminojë asnjëri mbi bazën e racës, gjinisë, origjinës etnike, fetare, filozofike, opinion politik, gjendjes civile apo çështje të tjera.
 - c. Të mos tolerojë asnjë tentative për agresion fizik, moral apo mendor.
 - d. Të ndalojë çdo formë që shoqërohet me dhumin të karakterit fizik, mendor, moral, profesional apo gjinor.
 - e. Të garantojë kushte për një siguri të favorshme, sjellje të mirë dhe kujdes mjekësor për ruajtjen e ekuilibrit fiziko-mendor të çdo individ.
- 2.3 **Integritet:** do të thotë të qëndrosh lartë me karakter, duke luftuar të gjitha format e sjelljeve jo korrekte dhe ti përballësh situatave të jetës me forcën morale, ndershmërinë dhe mos korruptimin. Çdo anëtar i FSHV duhet:

- a. Të mos krijojë direkt apo indirekt mundësi përfitimesh të cilat janë në kundërshtim me rregullorët e FSHV-së.
- b. Të mos pranojë apo të përfitojë çdo lloj dhurate personale, privilegji personal direkt apo indirekt, me qëllim përfitimit të ndonjë vendi zyrtar në FSHV.
- c. Vetëm dhuratat në vlerë të vogla të njohura dhe nga shteti, mund ti jepen apo pranohen nga anëtarët e FSHV, në shenjë respekti dhe mirënjohje miqësore.
- d. Të shmangin çdo konflikt interesi që ka të bëjë me shoqatën që ai përfaqëson, brenda interesave të përgjithshme të FSHV.

2.4 **Besnikeria:** do të thotë aleanca e vazhdueshme me FSHV, duke ju bindur e respektuar gjithmonë statutin e saj, rregulloret, vendimet, përfshirë dhe principet etiko-sportive që kërkohen nga FSHV. Çdo anëtar i FSHV duhet:

- a. Të mos përfshihet dhe të bashkëpunojë me organizata apo persona, aktiviteti i të cilëve është në kundërshtim me principet e statutit e rregullores së brendshme të FSHV-së.
- b. Të mos pranojë rinumërimin e votave apo ndërhyrjen në ndonjë lloj forme të pa pranueshme brenda FSHV-së. Ai kurdoherë mund të diskutojë hapur dhe lirisht preferencat apo opinionet e tij në kërkim të zgjedhjeve më të mira, që janë në shërbim të volejbollit dhe interes të FSHV-së.
- c. Të mos praktikojë përdorimin e Dopingut, në të gjitha nivelet dhe në të dy gjinitë. Substancat Doping janë rreptësisht të ndaluara.

- d. Të bëjë të gjitha përpjekjet e tij për të mbajtur raporte sa më të mira e frutdhënëse me organet drejtuese të FSHV-së, autoritetet e shtetit, Komitetit Olimpik, sponësorët, median, në përputhje me principet e gjithëpërfshirjes, neutralitetit politik dhe pavarësisë.
- e. Të inspirojë gjithmon, shpirtin e humanizmit, vëllazërisë dhe respektit për të drejtat e individit i cili çon përpara idealet sportive të kërkuara nga çdo klub apo Shoqatë sportive për organizimin e aktiviteteve sportive të volejbollit.
- f. Të rrisë besueshmërin dhe të zbatojë me korrektësi besimin e dhënë nga drejtuesit e FSHV.

2.5 **Përgjegjësia:** do të thotë performancë e arritur nga një individ pavarësisht nga detyra dhe funksioni që ai mban, në interesin me të mirë të tij, për zhvillimin cilësor të volejbollit dhe në respektim të plotë të Statutit dhe rregulloreve të FSHV. Anëtarët të FSHV duhet:

- a. Të mos shkelin asnjëherë Statutin dhe Rregulloret. Ata nuk duhet të shprehin opinione false dhe disinformuese, me qëllimin e prishjes së reputacionit të individit apo prishjen e imazhit të FSHV-së dhe anëtarëve të saj.
- b. Të jenë përgjegjës për veprimet e ndodhura nga Klubet, Shoqatat, ekipet, tranjerët, lojtarët dhe gjyqtarët e Volejbollit, sa herë që ato janë në kundërshtim me Kodin e Etikës.
- c. Klubet dhe Shoqatat Sportive janë përgjegjëse gjithashtu për individët apo grupe individesh të cilët veprojnë në kundërshtim me rregulloret, shkaktojnë sjellje e kryejnë xheste antisportive, si dhe kundërshtojnë me forcë vendime të ndryshme, gjatë

aktivitetive zyrtare të volejbollit dhe beach-volley-it. Këtu përfshihen gjithashtu dhe sjelljet e qëndrimet e vetë drejtuesve të klubeve e shoqatave sportive, manaxherëve e sponsorëve të ekipeve, lojtarëve, trajnerëve e gjyqtarëve.

Rregulli 3: Konflikti i Interesit

3.1 **“Person me konflikt interesi”** sipas këtij kodi, do të thotë një anëtar i FSHV i cili është zgjedhur në një organ të FSHV, që është vendimmarrës.

3.2 Organet vendimmarrëse që përfshihen në konfliktin e interes sipas statutit të FSHV janë si më poshtë:

1. Asamblea e Përgjithshme
2. Presidenti
3. Komiteti Ekzekutiv
4. Komisioni i Disiplinës
5. Komisioni i Apelit
6. Komisioni Tekniko-Arbitral
7. Komisioni Financës

3.3 **"Interes"** do të thotë:

Përfitime personale direkt apo indirekt i të drejtës së një titulli apo funksioni të pa merituar, përfitimi i avantazheve apo fitimeve personale, si rezultat i mbajtjes së funksioneve në organet e FSHV-së.

- a. Përfitime personale direkt apo indirekt, përfitimi i avantazheve personale nëpërmjet implikimit të njerëzve të tjerë, për këtë qëllim.
- b. Përfitime personale direkt apo indirekt të personave që nuk janë anëtare të FSHV-së, nëpërmjet shfrytëzimit të veprimtarive të volejbollit për qëllim përfitimi personal.

3.4 "Konflikt" do të thotë:

- a. Qëndrimi i kundërt ndërmjet dy veprimeve të njëpasnjëshme, që lidhen me mbajtjen e një funksioni dhe arritjen e një përfitimi apo avantazhi personal të pa merituar, që është pasojë e këtij funksioni.
- b. Angazhimi personal apo material në Klube e shoqata sportive me qëllimin e përfitimeve apo pozicioneve personale.

3.5 "Konflikt Interesi" do të thotë një situatë kur një person:

- a. Mund të nxjerrë fitime apo të krijojë avantazhe personale, direkte apo indirekte nga persona të tretë, si rezultat i vendimeve të tij, që rrjedhin nga funksioni i tij zyrtar.
- b. Mund të mos plotësojë detyrën e tij zyrtare për arsye të implikimit të tij me klube, shoqata sportive apo ekipe të ndryshme, nga të cilat rrjedhin përfitime e avantazhe personale të pa merituar, si pasojë e funksionit të tij.
- c. Mund të mos jetë i lirë të shprehë opinionin e tij ose të vendosë vetë për situatën e krijuar, si pasojë e implikimit me persona të tjerë të cilët konsiderohen me influencë dhe ndikojnë në gjykimin e vendimin e pavarur të tij.

3.6 Konflikti i Interesit është i ndaluar.

- 3.7 Çdo individ i zgjedhur në organet vendimmarrëse të FSHV, që kërkon të përmbushë funksionin e tij, për llogari të ndonjë anëtari,

sponsori apo partneri të FSHV-së, duhet detyrimisht të deklarojë ndonjë mundësi të konfliktit të interesit në kryerjen e funksionit të tij.

RREGULLORE E DISIPLINËS E FSHV

KAPITULLI 1

SHTRIRJA E KODIT TË DISIPLINËS

Aplikimi

Neni 1. Sipas parimeve të FSHV, personat përgjegjës të Klubeve e Shoqatave Sportive, Trajnerët, Lojtarët, Gjyqtarët dhe të gjithë pjesëmarrësit në veprimtaritë zyrtare dhe miqësore Kombetare e Ndërkombëtare, janë të detyruar të zbatojnë në mënyrë rigoroze Statutin, Rregulloren e Brendëshme, Rregulloren Teknike, Rregulloren e Disiplinës, Kodin e Etikës, vendimet e miratuara nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv, si dhe të gjitha vendimet e marra e të miratuara nga organet vendimmarrëse respektive të FSHV.

Neni 1.1. Në rast të shkeljes së rregullave do të aplikohen sanksione dhe gjoba, që janë të parashikuara në Kapitullin 2 të kësaj rregullore.

Personat dhe Organizatat Sportive që marrin sanksionet

Neni 1.2. Personat dhe Organizatat Sportive në përputhje me nenin 1 janë:

Klubet dhe Shoqatat Sportive të Volejbollit, personat zyrtarë të Klubeve dhe Shoqatave sportive, personeli ndihmës i Klubeve dhe Shoqatave Sportive, gjyqtarët, lojtarët, trajnerët, si dhe anëtarët e ekipeve të Volejbollit, në funksione të ndryshme.

Neni 1.3. Të gjithë personat sipas nenit 1.2 duhet të jenë të regjistruar në FSHV, që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në aktivitetet Zyrtare e Miqësore, Kombëtare e Ndërkombëtare të Volejbollit të organizuara, nga Federata Shqiptare e Volejbollit.

Klubi Sportiv dhe Shoqata Sportive:

Neni 1.4. Klubet / Shoqatat Sportive të Volejbollit dhe anëtarët e tyre janë përgjegjës për sjelljen e personave që i përfaqësojnë ato apo veprojnë në emër të tyre. Ato janë përgjegjëse dhe mbajnë përgjegjësi për sjelljen e tifozave të skuadrave të tyre.

Neni 1.5 . Përgjegjësia e Klubeve e Shoqatave Sportive për anëtarët e tyre: Klubet e Shoqatat Sportive janë përgjegjës për dënimet që mund të marrin për shkelje e veprime antisportive anëtarët e regjistruar në emrin e tyre, të cilët mund të jenë trajnerë, lojtarë, mjekë, drejtues, spektatorë, etj.

KAPITULLI 2

SANKSIONET

Neni 2. Sanksionet

Neni 2.1.

Sic parashikohet në statutin e FSHV organet kompetente juridike të përcaktuara sipas kësaj "Rregullore e Disiplinës" mund të vendosin për sanksionet e mëposhtme:

- a) Këshillim, Qortim,
- b) Paralajmërim,
- c) Dënim me gjoba nga 5000 (pesëmijë) lek - 500.000 (pesëqindmijë) lek,
- d) Skualifikim nga ndeshja ose aktiviteti,
- e) Humbje e ndeshjes ose ndryshim i rezultateve,
- f) Modifikim i rezultatit të ndeshjes,
- g) Shkarkim nga funksioni zyrtar, në organet e FSHV,
- h) Pezullim të përkohshëm, nga aktivitetet zyrtare kombëtare,
- e) Ndërkombëtare,
- i) Përfjashtim të përhershëm nga aktivitetet dhe funksionet në FSHV.

Neni 2.2. Këshillimi përbëhet nga një deklaratë zyrtarë qortimi me shkrim, për fajin apo gjestin antisportiv të ndodhur në publik.

Neni 2.3. Paralajmërimi përbëhet nga një deklaratë zyrtare me shkrim, që aludon se në qoftë se do të ketë shkelje të mëtejshme ose xheste antisportive të përsëritura, sanksionet e ardhshme do të jenë më të rënda.

Neni 2.4. Një Dënim me gjobë konsiston në pagesën për FSHV-në e një shume të caktuar nga 5000 lek - 500.000 lek në përputhje me rregulloret e ndryshme të FSHV. Një gjobë e shkaktuar nga një ekip apo person që është anëtar i një ekipi do të paguhet nga vetë sportisti apo Klubi Sportiv ose Shoqata Sportive ku ai apo ajo bën pjesë.

Në çdo rast Klubi Sportiv apo Shoqata Sportive respektive është përgjegjëse karshi FSHV-së për pagesën e gjobës.

Neni 2.5. Skualifikimi nga ndeshja apo aktiviteti i një anëtari të një ekipi konsiston në ndalimin e pjesmarrjes së tij / saj në ndeshje apo aktivitete zyrtare. Ndalimi i pjesmarrjes së tyre mund të jetë për një ndeshje ose më shumë ndeshje., si dhe për të gjithë sezonin sportiv.

Neni 2.6. Humbja e ndeshjes ose ndryshim i rezultatit, të ndeshjes konsiston në ratifikimin e rezultatit, që duhet të rezultojë me një pikaverazh 0-3 (0 / 25 0/ 25 0 / 25) ose në Beach Volleyball 0-2 (0 / 21 - 0 / 21) kundër ekipit që ka marr dënimin.

Neni 2.7. Modifikimi i rezultatit të një ndeshjeje konsiston në anulimin e një ose më shumë pikëve të fituara më parë nga ekipi që merr sanksionin, gjatë një ndeshje apo turneu.

Neni 2.8. Shkarkimi nga funksioni zyrtarë do të thotë humbje të funksionit të mbajtur nga të gjitha organet e FSHV-së.

Neni 2.9. Pezullimi (Mospasja të drejtë) konsiston në ndalimin e pjesëmarrjes, për një periudhë të caktuar kohe, në çdo veprimtari zyrtare e miqësore të organizuara nga FSHV.

Pezullim mund të marrin të gjithë anëtarët e FSHV-së si edhe të gjithë personat e parashikuar në nenin 1.2 të kësaj rregullore.

Një pezullim i përkohshëm mund të aplikohet në rastet e veprimeve antisportive të rënda, para përfundimit të procedurës së dëgjimit nga organi përkatës, në mënyrë që të shmangen veprime të dënueshme të mëtejshme.

Neni 2.10. Përjashtimi konsiston në përjashtimin (dëbimin) nga të gjitha veprimtaritë Kombëtare e Ndërkombetare, zyrtare e miqësore të organizuara nga FSHV.

KAPITULLI 3

ORGANET KOMPETENTE PËR DHËNIEN E SANKSIONEVE

Neni 3. Organet e FSHV-së që kanë fuqi të marrin masa disiplinore dhe kanë kompetenca juridike në dhënieve të sanksioneve janë si më poshte vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Presidenti
3. Komiteti Ekzekutiv
4. Komisioni i Disiplinës
5. Komisioni i Apelit
6. Komisioni Tekniko - Arbitral
7. Komisioni Financës

Neni 3.1. Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime deri në pezullim të Klubeve Sportive, Shoqatave Sportive dhe ekipeve nga 1(një) deri në 4 (katër) vjet.

Neni 3.2. Komiteti Ekzekutiv

Komiteti Ekzekutiv është organi më i lartë kompetent për dhënien e dënimeve, për të gjithë personat e përfshirë në nenin 1.2 të kësaj rregullore.

Neni 3.3 Komiteti Ekzekutiv ka kompetencat për dhënien e Sanksioneve si më poshtë:

1. Paralajmërimet dhe vërejtjet me shkrim për Klubet, Shoqatat Sportive, ekipet, gjyqtarët e ndeshjeve, kryegjyqtarët dhe delegatët teknike.
2. Gjoka nga 5000 (pesëmijë) deri në 500.000 (pesëqindmijë) lek për Klubet e Shoqatat Sportive, individë, përfshirë trainerë, lojtarë, gjyqtarë e zyrtarë, që shkelin rregulloret, nuk respektojnë vendimet e marra nga organet e FSHV dhe abuzojnë me detyrën e funksionit të tyre.
3. Dënime për Gjyqtarë, Delegatë Teknikë, Kryegjyqtarë dhe Zyrtarë të aktiviteteve dhe ndeshjeve të volejbollit duke filluar nga:
4. Shkarkimi nga funksionet e detyrat zyrtare në strukturat e FSHV,
5. Pezullim të Gjyqtarit / ve apo Delegatit Teknik nga 6(muaj) deri në 2(dy) vjet nga të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqëruar me gjobë nga 30.000(tridhjetmijë) - 80.000(tetëdhjetmijë) lek.

6. Propozimin për pezullimin nga aktivitetet ndërkombëtare të gjyqtarit/ve ndërkombëtarë, duke vënë në dijeni për ngjarjen e ndodhur FIVB dhe CEV.
7. Largimin ose përjashtimin nga ekipet Kombëtare të trajnerëve, lojtarëve, menaxherëve, mjekëve, fizioterapistëve, masazhatorëve apo gjyqtarëve.
8. Largimin ose përjashtimin nga Veprimtaritë Ndërkombëtare të trajnerëve, lojtarëve, menaxherëve, mjekëve, fizioterapistëve, masazhatorëve apo gjyqtarëve.
9. Pezullimin e Klubit Sportiv apo Shoqatës sportive në raste urgjente.

Neni 3.4 Komiteti Ekzekutiv ka kompetencë për të vendosur për shpenzimet dhe dëmet e tjera që lidhen me përdorimin e substancave të ndaluara.

Neni 4. Komisioni i Disiplinës

Komisioni i Disiplinës është kompetent dhe ka të drejtë:

1. Të vendosë dënime, karshi gjeesteve e qëndrimeve antisportive, duke filluar nga pezullimi për 1(një) ndeshje deri 5 (pesë) ndeshje, shoqëruar me gjobë nga 10.000 (dhjetmijë) - 50.000(pesëdhjetmijë) lek, për trajnerë, lojtarë, gjyqtarë dhe zyrtarë, pjesmarrës në aktivitetet zyrtare.
2. Të vendosë dënime për të gjitha qëndrimet që janë në kundërshtim me rregulloren e brendëshme, rregulloren teknike dhe Kodin e

Etikës, duke filluar nga pezullim i përkohshëm nga funksioni zyrtar, shoqëruar me gjobë nga 5000 (pesëmijë) lek - 50.000(pesëdhjetmijë) lek.

3. Të vendosë për pezullim të përkohshëm nga aktiviteti zyrtar kombëtar dhe ndërkombëtar, për trajnerë, lojtarë, zyrtarë dhe gjyqtarë.
4. Të vendosë për përjashtim të ekipeve, lojtarëve, trainerëve, zyrtarëve të tyre, përgjithmone nga aktivitetet e volejbollit.
5. Të vendosë gjoba nga 10.000(dhjetmijë) deri në 100.000(njëqindmijë) lek për klube, shoqata, trajnerë, lojtarë, gjyqtarë, zyrtarë, etj.
6. Të paralajmërojë dhe dënojë me gjoba nga 10.000(dhjetmijë) deri në 40.000(dyzetmijë) lek, Klubet, shoqatat sportive, individë si trajnerë, lojtarë, gjyqtarë, zyrtarë, etj, që nuk kanë paguar detyrimet e tyre financiare karshi FSHV-së.

Neni 5. Komisioni Tekniko - Arbitral

Neni 5.1 Komisioni Tekniko - Arbitral | FSHV ka autoritetin të aplikoje në perputhje me "Rregulloren e Brëndëshme" dhe "Rregulloren Teknike" sanksionet e mëposhtme:

Neni 5.2. Kundër Ekipeve të Klubeve dhe Shoqatave Sportive:

- a. Këshillim me shkrim,
- b. Paralajmërim me shkrim,
- c. Ndryshim rezultati të ndeshjeve,

- d. Modifikim i rezultateve të ndeshjeve,
- e. Pezullim ose përjashtim nga ndeshja apo aktiviteti.

Neni 5.3. Kundër anëtarëve të Klubeve e Shoqatave Sportive në perputhje me Rregulloren Teknike të Volejbollit, përfshirë lojtarë, trajnerë, mjekë, drejtues, sponsorë, gjyqtarë, etj.

- a. Këshillim me shkrim,
- b. Paralajmërim me shkrim,
- c. Largimi për një ose më shumë ndeshje,
- d. Pezullim nga ndeshja apo i gjithë aktiviteti,
- e. Dënim me gjobë në lekë duke filluar nga 5000(pesëmijë) lek deri 50.000 (pesëdhjetmijë) lek.

Neni 5.4 Komisioni Tekniko - Arbitral për të gjitha rastet e gjesteve e qëndrimeve të rënda antisportive e antiqytetare, mund t'i propozojë Komisionit të Disiplinës aplikimin e sanksioneve shtesë.

Neni 5.5 Komisioni Tekniko - Arbitral duhet të informohet brenda 24 orëve me anë të proces verbalit të shkruar nga Delegati Teknik, apo Kryegjyqtari i ndeshjes apo vetë gjyqtari, për ngjarjen antisportive apo problemin e ndodhur, para, gjatë apo pas ndeshjes.

Neni 5.5.1 Proces verbali duhet të përmbajë në mënyrë të hollësishme të gjitha faktet e ndodhura, të cilat duhet t'i bashkëngjiten protokollit të

ndeshjes, për vlerësimin e plot të ngjarjes së ndodhur dhe për t'i prezantuar ato në rast nevojë në Komisionin e Disiplinës.

Neni 5.6 Komisioni Tekniko - Arbitral ka kompetencën për ratifikimin e rezultatit të ndeshjes dhe përgjegjësinë për klasifikimin e skuadrave në veprimtaritë zyrtare të volejbollit, bazuar në rregulloren teknike, rregulloren e brendëshme dhe rregulloren e veprimtarive kombëtare zyrtare.

Neni 6 Sjelljet jo korrekte në përgjithësi

Neni 6.1 Sjellje jo korrekte është çdo shkelje e Statutit, Rregullores së Brendshme, Rregullores Teknike, Kodit të Etikës dhe Rregullores së Disiplinës të FSHV, si dhe të gjitha vendimeve të marra nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV.

Neni 6.2 Sjellje jo korrekte kundër parimeve të veçanta.

Neni 6.3 Të gjithë personat fizike dhe juridike të përmendur në nenin 1 duhet t'i kryejnë detyrat e tyre në përputhje me Statutin e Rregulloret e FSHV.

Neni 6.4 Çdo shkelje e sjelljes së besnikërisë, ndershmërisë, paanësisë dhe korrektësisë sportive, e cila do të kryhet nga anëtarët e FSHV do të dënohet me sanksione nga organet kompetente, sipas kapitullit 2 dhe 3 të kësaj rregullore.

Neni 6.5 Sjellja Antisportive

Neni 6.5.1 Sjellja agresive gjatë një ndeshje apo turneu volejboli dënohet me përjashtim nga ndeshja apo turneu aktual si dhe ai pasardhës, dhe shoqërohet me sanksione e gjoba shtesë, nga 10.000(dhjetmijë) lek - 40.000(dyzetmijë) lek, që varen nga shkalla e rrezikshmerisë së veprimit apo sjelljes jo korrekte.

Neni 6.5.2 Klubet Sportive, Shoqatat Sportive, ekipet dhe trajnerët e skuadrave të Volejbollit janë sëbashku përgjegjës për sjelljen e tifozëve të tyre.

Neni 6.5.3 Në të gjitha rastet e sjelljeve jo korrekte nga ana e një pjese të tifozëve, ndodhisë së ndonjë aksidenti ose ndalimin e ndeshjes për shkak të sjelljes apo veprimeve të tifozëve Klubi Sportiv, Shoqata Sportive apo vet ekipi do të dënohet me gjoba që fillojnë nga 50.000 (pesëdhjetëmijë) lek deri në 500.000(pesëqindmijë) lek. Shuma e gjobës varet nga rrezikshmëria e sjelljes apo veprimit.

Neni 6.5.4 Në qoftë se sjelljet apo veprimet e tifozëve kompromentojnë vazhdimin normal të ndeshjes, ekipi i cili është përgjegjës për sjelljet e publikut do të dënohet me humbjen e ndeshjes 0-3 në voleyboll dhe 0-2 në beach-volley dhe me 0(zero) pikë në çdo set.

Neni 7 Shkelja e Rregullave të Ndeshjes.

Neni 7.1 Pandershmëria në Ndeshje

Neni 7.2 Klubet, Shoqatat Sportive e trajnerët e ekipeve janë përgjegjës në çdo rast, për sjelljet e pandershme nga ana e lojtarëve e drejtuesve të tyre, të cilat mund të ndikojnë në një rezultat të pandershëm apo në një klasifikim të pamerituar.

Neni 7.3 Çdo Klub, Shoqatë Sportive apo skuadër voleybolli e cila do të deklarohet përgjegjëse për veprimet e mësipërme, do të dënohet me humbjen ndeshjes 0-3 me sete 0-75, heqjen e të gjitha pikëve të renditjes në klasifikim dhe përjashtimin për 2 (dy) vjet nga të gjitha veprimtaritë Kombëtare e Ndërkombëtare të Voleybollit dhe Beach Volley-it.

Neni 7.4 Në rast se dhe ndonjë trajnerë, lojtarë apo gjyqtarë do të deklarohet fajtor për veprimet e sipërpërmendura, do të përjashtohet nga të gjitha funksionet e tij të rregjistruara në FSHV.

Neni 8 Përdorimi i substancave të ndaluara

Neni 8.1 Klubet e Shoqatat Sportive janë përgjegjëse për përdorimin e substancave të ndaluara nga ana e lojtarëve të tyre.

Neni 8.2 Në rast se nga verifikimi mjekësor sipas standartave të njohura nga FIVB vërtetohet përdorimi i substancave të ndaluara nga lojtarët, atëherë Klubi apo Shoqata Sportive që i përket lojtari duhet:

- a) Lojtari / ja duhet të përjashtohet menjëherë nga ndeshja apo aktiviteti dhe skuadra e tij / saj do të humbë ndeshjen.
- b) Në rast se Lojtari / ja do të deklarohet që ka përdorur substanca të ndaluara pas përfundimit të aktivitetit apo fitimit të medaljeve, ekipit i hiqet e drejta e medaljeve dhe duhet t'i kthejnë ato.

Neni 8.3 Lojtari / ja që do të deklarohet si përdorues / se e substancave të ndaluara do të përjashtohet për 2(dy) vjet nga të gjitha aktivitetet Kombëtare e Ndërkombetare.

Neni 8.4 Në rast se do të provohet se trajnerët, menaxherët, mjekët apo zyrtarë të tjerë të Klubeve apo Shoqatave Sportive janë përgjegjës për përdorimin e substancave të ndaluara nga ana e sportistëve të tyre, ata do të përjashtohen nga të gjitha aktivitetet Kombëtare e Ndërkombëtare dhe do të gjobiten me gjoba nga 30.000 lek - 100.000 lek.

Neni 8.5 Refuzimi nga ana e lojtarit e kryerjes së testit për përdorimin e substancave të ndaluara do të konsiderohet si përdorues (me rezultat pozitiv).

Neni 9 Gjyqtaria

Neni 9.1 Gjyqtaret të cilët detyrën e tyre e kryejnë në mënyre të pandershme gjatë një ndeshje apo turneu zyrtarë ose miqësor do të pezullohen nga detyra e funksioni i tyre si gjyqtar për ndeshjet ose turneun dhe për ta do të ketë dhe sanksione dënim shtesë si:

- Pezullim nga 1(një) deri 2 (dy) vjet nga aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të gjobiten me shumën nga 5000 (pesëmijë) deri në 50.000 (pesëdhjetmijë)

Neni 9.2 Në rastet kur do të provohet korrupsion i çdo forme nga ana e gjyqtarëve dhe në rastet kur ata përfshihen në afera korruptive dhe veprimtari ilegale, do të përjashtohen përgjithmonë nga FSHV dhe do të gjobiten nga 30.000(tridhjetmijë) lek deri në 100.000 (njëqindmijë) lek.

Neni 10 AKTIVIZIMI i Lojtarëve të pa licensuar.

Neni 10.1 Klubet e Shoqatat Sportive pjesëmarrëse në aktivitetet zyrtare të FSHV të cilat do të lejojnë në skuadrat e tyre rregjistrimin e aktivizimin

e lojtarëve të pa rregjistruar dhe licensuar në sekretariatin e FSHV ose vendosjen e tyre në fletët e vendosjes së skuadrës për lojë do të dënohen me gjobë nga 10.000(dhjetmijë) lek deri 200.000(dyqindmijë) lek.

Neni 10.2 Klubi, Shoqata Sportive dhe lojtari përgjegjës do të pezullohen për 1(një) vit nga të gjitha veprimtaritë e volejbollit Kombëtare dhe Ndërkombëtare të FSHV, dhe skuadra do të humbe të gjitha ndeshjet e luajtura me këtë lojtar. Lojtari individualisht do të gjobitet me 80.000(tetëdhjetmijë) lek.

Neni 11. Mos fillimi i ndeshjes në kohën e përcaktuar..

Neni 11.1 Një ndeshje do të deklarohet aforfe në rast se ajo nuk fillon brenda 30 minutave të parashikuara në rregulloren e brëndëshme. Në këtë rast skuadra e cila nuk është paraqitur do të gjobitet me 60.000 lek, për prishje të imazhit të Organizatorit dhe FSHV.

Neni 11.2 Ekipi që nuk paraqitet në ndeshje e humb atë. Në rast përsëritje nga e njëjta skuadër, ajo do të humbë të gjithë rezultatet e arritura dhe do të përjashtohet nga i gjithë aktiviteti, si dhe do të marr rrjedhimisht sanksionet e parashikuara në rregulloren e brendëshme të FSHV.

Neni 12 Sulme e shpifje publike kundër personave zyrtarë e FSHV

Neni 12.1 Për sulme e shpifje të bëra në publik nga persona që marrin pjesë në aktivitetet e Volejbollit dhe Beach Volley-it, në dëm të personave zyrtarë të caktuar në aktivitetet e FSHV, si dhe karshi drejtuesve të FSHV,

do të dënohen me përjashtimin nga aktiviteti ku ata marrin pjesë dhe do të gjobiten nga 30.000(tridhjetmijë) lek deri 100.000(njëqindmijë) lek.

Neni 12.2 Në raste të veprimeve e sulmeve të qëllimshme për prishjen e imazhit të FSHV personi apo personat që do të kryejnë veprime të tilla do të përjashtohen nga 1 deri 3 vjet nga të gjitha aktivitetet Kombëtare e Ndërkombëtare të Volejbollit dhe do të gjobiten nga 100.000(njëqindmijë) deri në 500.000 (pesëqindmijë) lek.

Neni 13 Rregulli Juridik Unik i FSHV

Neni 13.1 Në të gjitha rrethanat klubet, shoqatat, trajnerët, lojtarët, gjyqtarët, delegatët teknikë e zyrtarët e regjistruar në sekretariatin e FSHV, nuk kanë të drejtë të apelojnë vendimet e marra nga organet e FSHV në organizma të tjera juridike, civile apo sportive, sidomos kur bëhet fjale për shkelje të karakterit teknik dhe organizativ, të parashikuara në rregulloret e funksionimit të FSHV, të cilat ndikojnë negativisht në mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe bien ndesh me politikën e kërkuar nga Komiteti Ekzekutiv, për zhvillimin e volejbollit në Republikën e Shqipërisë, rregulloret e FSHV dhe standartet e parashikuara në rregulloret e FIVB dhe CEV.

Neni 14 Apelimi

Neni 14.1 Sanksionet e marra nga anëtarët e FSHV, që nuk përfshihen në nenin 13.1 mund të apelojnë në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv pranë KOKSH brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

MIRATUAR NGA KOMITETI EKZEKUTIV I FSHV-së Maj, 2023

Presidenti
Erlind PELLUMBI

Sekretari i Përgjithshëm
Ervis DOSTI

Shënim: Ky dokument hyn në fuqi menjëherë. Dokumenti i mëparësh shfuqizohet.